

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore  
Savet Kosova za Kulturno Nasleđe  
Kosova Council for the Cultural Heritage

# Promovimi i Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore

Filigrani dhe tradita e pikturimit të fytyrës së nuses

Prishtinë, 2022

## **Promovimi i Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore**

Filigrani dhe tradita e pikturimit të fytyrës së nuses

**Redaktor:** Kreshnik Bajraktari

**Kopertina dhe  
përgaditja teknike:** Korab Kraja

**Shënimet dhe  
fotografitë i mbledhi:** Argjenda Kojqini

**Fotografitë:** © Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore  
© Pjesëmarrësit në projekt

**Shtypur në:** Office Printy

**Botues:** Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore

+383 (0) 38 211 617

+383 (0) 38 211 587


0800 111 10

kktk@rks-gov.net

## **PËRMBAJTJA:**

Zanita Halimi <b>RËNDËSIA E TRASHËGIMISË KULTURORE SHPIRTËRORE</b> .....	6
Kreshnik Bajraktari <b>ORGANIZIM I PROJEKTIT PROMOVUES</b> .....	8
Argjenda Kojqini <b>PSE KINO LUMBARDHI?</b> .....	12
Prof. Dr. Drita Halimi - Statovci <b>FILIGRANI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS</b> .....	18
Betim Elezi <b>PIKTURIMI I FYTYRËS NË KOSOVË</b> .....	26
<b>“ZEJA TRADICIONALE E FILIGRANIT” NË QYTETIN E PRIZRENIT</b> .....	36
Enis Bytyqi <b>FILIGRANI – ZEJE E NGRIRË NË KOHË</b> .....	38
Aranit Krasniqi <b>PËRBALLË NJË TRADITE MIJËVJEÇARE NUSËRIE</b> .....	43
<b>AKTIVITET PËR T’U SHËNUAR</b> .....	51





## Zanita Halimi

Kryetare e Bordit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

### RËNDËSIA E TRASHËGIMISË KULTURORE SHPIRTËRORE

Trashëgimia kulturore është një vlerë e shquar e kulturës së një populli, vlerë e cila tejkalon kufijtë e rëndësisë nacionale. Në kohët e fundit termi Trashëgimi Kulturore ka ndryshuar përmbatjen, pasi nuk kemi të bëjmë vetëm me monumente dhe koleksione artefaktesh. Por, trashëgimia kulturore përfshin traditat të trashëguara nga të parët tanë dhe të përcjellura tek gjeneratat e reja.

Sic janë traditat gojore, artet skenike, praktikat shoqërore, ritualet, ngjarjet festive, njohuritë dhe praktikat në lidhje me natyrën dhe universin dhe aftësitë për zej të tradicionale. Këto janë pesë fushat në të cilat manifestohet trashëgimia kulturore shpirtërore sipas Konventës së UNESCO-s të vitit 2003 për ruajtjen e trashëgimisë kulturore shpirtërore.

Trashëgimia kulturore shpirtërore është një faktor i rëndësishëm në ruajtjen e diversitetit kulturor përball globalizimit. Rëndësia e trashëgimisë kulturore shpirtërore nuk është vetë manifestimi kulturor, por pasuria e njohurive dhe aftësive që transmetohen nëpërmjet saj nga një brez në tjetrin.



Fig. 1. Zanita Halimi, kryetare e Bordit të KKT'K-së

Për t'u mbajtur gjallë, trashëgimia kulturore shpirtërore duhet të jetë e rëndësishme për komunitetin e saj. Ajo duhet të rikrijohet vazhdimisht dhe të transmetohet nga një brez në tjetrin. Ekziston rreziku që disa elementë të trashëgimisë kulturore shpirtërore mund të shuhen ose zhduken pa përkujdesje. Por ruajtja nuk do të thotë ngrirje e trashëgimisë kulturore shpirtërore në një formë të pastër ose fillestare. Ruajtja e trashëgimisë kulturore shpirtërore ka të bëjë me transferimin e njohurive, aftësive dhe kuptimit.

Trashëgimia kulturore shpirtërore është një pjesë thelbësore e asaj që përbën historitë dhe identitetet tona, të kuptuara si praktika, ide, njohuri dhe përvoja.

Ekziston një ndërgegjësim në rritje për rëndësinë e trashëgimive kulturore, pasi ato tregojnë mënyrat në të cilat njerëzit bashkohen për t'u lidhur dhe për t'u shprehur. Për më tepër, praktikat kulturore përbëjnë një element jetik të identitetit të një komuniteti. Njohja për traditat e njëri-tjetrit krijon një shtyllë kurrizore për mënyrën se si ndërveprojmë me njëri-tjetrin dhe na ndihmon të kuptojmë dallimet, si dhe të zbulojmë ngjashmëritë dhe vlerat e përbashkëta.

Për shkak të globalizimit, industrializimit dhe sfidave mjedisore, koleksionet e paprekshme- si çdo lloj tjetër trashëgimie- rrezikojnë dëmtimin, shkatërrimin dhe madje zhdukjen. Prandaj, është më e rëndësishme se kurrë të investojmë në strategjitë e mbrojtjes, duke shfrytëzuar njohuritë që kemi tashmë dhe duke evoluar vazhdimisht teknologjitë e reja dixhitale.

Andaj, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore do të mundohet që të punojë për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore shpirtërore me institucionet relevante dhe komunitetin në përgjithësi.

## **Kreshnik Bajraktari**

Zëvendës Udhëheqës Ekzekutiv

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore

### **ORGANIZIMI I PROJEKTIT PROMOVUES**

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore është institucion publik i rëndësishëm, i mandatuar kryesisht me aspekte të vlerësimit, mbrojtjes ligjore dhe statusore për trashëgiminë kulturore në vend. Ndërlidhur me gjendjen e trashëgimisë shpirtërore të rrezikuar nga zhvillime lokale e globale, me vështirësi rreth ruajtjes dhe përcjellës së njohurive mjeshtërore dhe artistike të krijuara e punuara ndër breza në vendin tonë, KKTK e ka parë të arsyeshme që në kuadër të përgjegjësive dhe në përputhje me mundësitë modeste institucionale, të ndërmarrë veprime konkrete. Kështu, me qëllim për të nxjerrë nga harresa dhe për të kthyer vëmëndjen, si dhe për të promovuar sadopak zejen e bukur të filigranit në qytetin e famshëm të tij, Prizren, kemi organizuar projektin ndërkombëtar me titull “Zeja Tradicionale e Filigranit”.

Prandaj, duke marrë në konsideratë rëndësinë e kësaj zeje mbresëlënëse të krijuar nga duart e arta të artizanëve vendas në Prizrenin e njohur për mjeshtritë dhe qindra zejet tradicionale që në një kohë, kishin mbërritur zenitin e zhvillimit të tyre. Në shekullin e 19-të, qyteti i Prizrenit kishte arritur kulminacionin e zhvillimit zejtar artizanal, me 27 zeje metalpunuese të ndryshme, si artarë,



Fig. 2. Gjatë fjalës përshëndetëse

argjendarë dhe armëtar (hashermexhinjtë), të cilët me punën e tyre që zbukuronin ato, duke aplikuar teknikën e bukur të filigranit. Niveli i lartë i zhvillimit dhe arritshmërisë së zejes së argjendarisë, përkatësisht filigranit, dëshmohej jo vetëm nga begatitë e punimeve artistike unike, por edhe nga profilizimi apo nëndarja në degë specifike të veçanta.

Kështu, duke u kthyer në realitetin e sotëm, më 3 tetor 2022, KKTK në kuadër të Ditëve të Trashëgimise Kulturore Evropiane, organizoi projektin ndërkombëtar që nisi me aktivitetin “Promovimi i trashëgimisë kulturore jomateriale me fokus – zeja e filigranit” të mbajtur në Kino Lumbardhi, Prizren.



Ky aktivitet me qëllim edukues dhe promovues filloi me prezantimin mbresëlënës të Prof. Dr. Drita Halimi – Statovci, themeluese e Departamentit të Etnologjisë, para aduencës dhe studentëve nga vende të ndryshme, kryesisht evropiane, duke iu dhënë mundësi të njiheshin me studimin e hulumtimet shumevjecare të saj rreth kësaj zeje. Programi përfshinte edhe prezantimin e pasionantit të trashëgimisë kulturore

vendore Jeton Jagxhiu, të karakterizuar sidomos me përshkrimet dhe hulumtimet entuziaste të traditave dhe recetave të gatimeve unike të rajonit të Prizrenit, si djathi i Sharrit etj.

Ndërkohë, vëmendjen e audiencës e mori demonstrimi i një tradite sa të lashtë po aq tërheqëse për nuancat e saj – vizatimi, pikturimi i fytyrës së nuses. Një pasuri kjo krijuese, artistike dhe magjike që u realizua nga znj. Aziza Shefitagiq. Ajo ndoshta është e vetmja që vazhdon ta ushtrojë dhe ruajë pikturimin e fytyrës së nuses, në një zonë të thellë malore në rajonin e Prizren që e ka ruajtur të paprekur deri më sot këtë pasuri që fillimisht duhet të njihet dhe të ruhet si trashëgimi e gjallë kulturore shpirtërore e vendit.

Aktiviteti promovues u përmbyll me shfaqjen e filmit dokumentar “Udhëve të Argjendarëve”, me regji të Rina Gecit në sallën e Kino Lumbardhit, gjithashtu një aset i trashëgimisë kulturore arkitekturore.

Të pranishmit, në veçanti studentë të vendeve të ndryshme, patën mundësi të njihen përmes prezantimesh me zhvillimin historik, teknikat e punimit dhe vlerat artistike të filigranit famëmadh. Duke krijuar kështu një pasqyrë të kompletuar rreth kontekstit në të cilin u paraqit dhe u zhvillua zeja e mirënjohur për punimet unike – filigrani shqiptar, i shumëkërkuar në shkallë globale për kohën, pra në tri kontinente: Evropë, Azi dhe Afrikë.



## **Argjenda Kojqini**

Zyrtare e lartë për trashëgimi arkitekturale  
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore

### **PSE KINO LUMBARDHI?**

Të rehabilitohet një aset i trashëgimisë kulturore apo të mbetet i pashfrytëzuar e në mëshirë të kohës, është një diskutim për të cilin gjithmonë ka pasur e do të ketë debate. Këto diskutime vazhdojnë që nga kohët e Viollet le Duc dhe John Ruskin kur i pari ishte për restaurim dhe rehabilitim të monumenteve, derisa i dyti për mirëmbajtje e ruajtje të tyre sipas gjendjes burimore pa bërë ndërhyrje restauruese.

Në kohën e sotme moderne në përgjithësi vëmendja më e madhe i kushtohet rehabilitimit të ndërtesave, me theks të veçantë monumenteve arkitekturale-historike. Rastet e ndryshme në botë kanë vërtetuar se me rifunksionalizimin e ndërtesave, ansambleve historike, përveç se është mundësuar qëndrueshmëria e menaxhimit të tyre ka ndikuar edhe në zhvillim të turizmit për atë zonë ku ndodhen këto asete. Nëse do i konsideronim asetet e trashëgimisë kulturore si produkte atëherë do të kuptonim se ne nuk mund t'i ndryshojmë ato sepse i kemi trashëguar si të tilla nga e kaluara, mirëpo ajo çka ne do të mund të bënim është zhvillimi, përdorimi dhe promovimi i këtyre produkteve. Duke ditur rëndësinë e tyre në identifikimin e historisë dhe kulturës së një kombi, restauratorët sot po hasin vështirësi në rifunksionalizimin e tyre. Secili monument është ndërtuar sipas kërkesave dhe funksionit të kohës së ndërtimit, e këto shpesh herë janë në kundërshtim me kërkesat e kohës së sotme.

Sfida kryesore aktuale është gjetja e një balanci të duhur në mes konservimit dhe restaurimit të monumentit duke iu adaptuar funksionit të ri. Përderisa konservimi sipas Kartës së Venecias nënkupton “të ruajë siveprën e artit ashtu edhe dëshminë e historisë” (Konferenca e II Ndërkombëtare e Arkitektëve dhe teknikëve të monumenteve, Karta e Venecias për konservimin dhe restaurimin e monumenteve, 1964), rehabilitimi në anën tjetër sipas këtij dokumenti lejohet nëse “Konservimi i monumenteve është gjithmonë i favorizuar nga destinimi i tyre për një funksion të dobishëm për shoqërinë, një destinim i tillë është pra i dëshirueshëm por ai nuk duhet të ndryshojë kompozimin ose dekorin e ndërtesës. Vetëm në këta kufij mund të konceptohen dhe mund të autorizohen përshtatjet e kërkuara nga ndryshimi i funksionit.” (Konferenca e II Ndërkombëtare e Arkitektëve dhe teknikëve të monumenteve, Karta e Venecias për konservimin dhe restaurimin e monumenteve, 1964).

Fig. 3. Pjesëmarrësit gjatë aktivitetit



Një shembull i mirë se si të rehabilitohet monumenti pa e cenuar veprën artistike si dhe dëshminë historike është ndërtesa e Kino Lumbardhit në qytetin historik të Prizrenit, shtëpia mikpritëse për aktivitetin tonë “Promovimi i trashëgimisë jo materiale – në fokus filigrani”.

Duke tërhequr shikuesit e filmit që nga viti 1952 kur dhe u përrua, Kino Lumbardhi i vendosur në Qendrën Historike të Prizrenit, paraqet mishërim të kinemasë së epokës moderne socialiste. Është njëra ndër ndërtesat më të vjetra publike në Prizren e cila ka shfrytëzuar teknologjitë dhe aparaturat e projektimit përmes shiritit filmik 35 mm, karakteristikë për kinematë e shek. XX.

Me fasadë të thjeshtë lineare, vërehet se arkitekti ka dhënë zgjidhje të thjeshtë sa i përket elaborimit të fasadës duke u mbështetur më shumë në vëllim dhe zgjidhjen e brendshme të ndërtesës. Porta hyrëse e bardhë, e cila ndanë kinemanë nga ndërtesat tjera përreth, të shpien në oborr aty ku dhe fillon rrugëtimi për në këtë ndërtesë e cila ishte pjesë e pandashme e jetës sociale dhe kulturore të qytetarëve të Prizrenit për shumë kohë. Hapësira e parë me të cilën përballesh si vizitor është salla e hapur me mbi 728 ulëse, vendtakim i shfaqjeve, ahengjeve e festivaleve të ndryshme, si festivali i muzikës qytetare të Kosovës – Zambaku i Prizrenit. Përmes portës nga druri me bishkrimin lartë LUM-BA-RDHI, i cili është bërë edhe si logo identifikuese e kësaj ndërtese, hyhet në hollin hyrës i cili të njëjtën kohë shërben si kafene, foaje, vendtakim për punë etj. për të vazhduar më tutje në katin e parë ku ndodhet dikur dhoma e emetimit. Dhoma e emetimit sot shërben si arkiv i kinemasë ku ende ruhen makineritë me teknologji të vjetra të emetimit të filmit si dhe shumë materiale e shirita filmik të cilat janë shfaqur gjatë viteve kur kinemaja ka qenë funksionale.


Ndërsa, po të qëndrojmë ende në përdhese, në anën e djathtë nga hyrja kryesore, është hyrja për në sallën qendrore të mbyllur, aty ku fillon narrativa e kësaj ndërtese. Salla qendrore e mbyllur me mbi 693 ulëse zhvillohet me planimetri drejtkëndëshe, ku në momentin që mbyllen dyert dhe përshkohet rruga deri në skenë, të jepet ndjesia se po i përjeton të gjitha skenat e filmave të shfaqur e të performuar nga doajenët e filmit shqiptar e të huaj. E njohur fillimisht si Kino Bistrica, që nga përrurimi i saj e deri më sot, në këtë ndërtesë janë shfaqur repertuar të filmave nga vende të ndryshme të botës si: Hollywood-i i Amerikës, repertuari i filmave evropian e deri tek prodhimet e Kosovafilmit.


Përgjatë mbi 70 vite të ekzistencës së saj, kinemaja kishte fatin e shumë ndryshimeve në funksion, ndërsa për një periudhë rrezikohej rrënimi i saj i tërësishëm. Pas shumë vitesh përpjekjeje nga përfaqësues të shoqërisë civile dhe organizatave kulturore nga Prizreni për të ndaluar këtë, kinemaja më në fund i është kthyer qytetarëve, si pjesë e shoqërisë bashkëkohore duke ushtruar funksionin burimor – shfaqjen e filmave.

Sot, Kino Lumbardhi është pjesë e listës së trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme, ndërsa është në pritje të shpalljes si aset i trashëgimisë arkitekturale në mbrojtje të përhershme nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore.



Fig. 4. Pjesëmarrësit para Kino Lumbardhit me studenten - nuse





**Prof. Dr. Drita Halimi – Statovci**


Studiuese e etnologjisë

## FILIGRANI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Në bashkëpunim të mirë me KKTK-në mora përsipër të mbaj një ligjëratë për filigranin tonë, për një grup studentëve të huaj dhe të studentëve të Universitetit të Prishtinës. U njoftova se studentët vijnë nga vende e shtete të ndryshme të Evropës. Kisha njohuri dhe kisha studime për zejtarinë në përgjithësi dhe pak a shumë edhe për filigranin në veçanti. Mirëpo e zura vetën në siklet se me çfarë metode ta realizoj dhe si ta bëj sa më atraktive këtë ligjëratë për studentët e huaj, por edhe për studentët tanë. KKTK e vlerëson dhe e promovon institucionalisht këtë mjeshtëri apo zeje metal përpunuese, por ama artistike. Natyrisht ligjërimi me slajde shfaqet i preferuar gati se gjithkund dhe disi një mënyrë u gjet për ligjërim. Por, duhej edhe më shumë, duhej diçka tjetër e diçka ndryshe. Zeja e argjendarisë, me emërtime e kujunxhinjve, e artarëve, e filigranit sot ngadalë e pahetueshëm po perëndon, por përballë kësaj qëndron interesimi dhe vullneti i fortë i punonjësve-zyrtarëve të lartë të KKTK-së, që kjo zeje të qëndrojë e të ringjallet. Madje ka edhe mjeshtër filigranistë që e dëshirojnë ringjalljen e filigranisë. Por, si me e lidhë shkëlqimin e dikurshëm të argjendarisë në Kosovë, dhe në anën tjetër gjendjen jo të mirë sot? Erdha në përfundim se kjo ligjëratë duhet t'i ngjajë një



Fig. 5. Prof. Dr. Drita Halimi – Statovci gjatë ligjëratës  
“Filigrani në Republikën e Kosovës”



tregimi, një storjeje të stilit: na ishte njëherë...! Po, saktësisht kështu.


Studentët i përshëndeta me fjalët: mirë se vini në Prizren, më të bukurin qytet të Kosovës, në qytetin lider të filigranit dhe në ligjëratën “Filigrani në Republikën e Kosovës”. Kjo zeje shquhet për punesë të hollë dore, që të zgjon shumë kërshtëri, por edhe të jep shumë kënaqësi dhe të falë ndjenja dhe emocione tepër të veçanta!

### **Pak të dhëna historike**

Secili nga ju besoj keni dëgjuar ose lexuar për zejen e argjendarisë përgjithësisht, për përpunimin artistik të metaleve fisnike. Mirëpo, sot ju

dhe unë së bashku do ta thurim një storie të bukur dhe interesante për mjeshtërinë e filigranit të kohës aktuale, këtu në Kosovë. Fillimisht argjendaria, që më vonë u quajt filigran nuk është zeje e re, realisht është një zeje profesionale me histori të pasur, me disa emërtime dhe me prodhimet e veta të bukura që të mahnitin si dje ashtu edhe në kohën e sotme. Gjetjet arkeologjike dhe materialet dokumentuese tregojnë për artefaktet – mjete përdorëse, ose stoli të bronzit, të hekurit, të argjendit dhe të arit, të njohura gjerësisht në trojet shqiptare, dhe jo vetëm në





rrethina të Prizrenit, që në antikitet e nga koha ilire. Në botimet për gjetjet arkeologjike tregohen stoli bronzi dhe argjendi, ose ari, p.sh., në Shirokë afër Prizrenit, ose në Banjë të Pejës, që i përkasin shekujve VI-V, p.e.r. ose VII-VI p.e.r. Më vonë gjetjet arkeologjike shpërfaqin stoli të bukura taman filigranike me teknikat rrahje, shkrirje ose me kokrra, si në Gllamnik (Vindenis) të Podujevës, të shek. IV, në Matican të Prishtinës shek. X-XI, në Përqevë afër Klinës shek. X-XIII, në Velekincë të Gjilanit shek. XI-XV e të tjera. Të dhëna të shkruara ku përmendet zeja e argjendarisë vijnë për kohën e mesjetës së hershme dhe të mesjetës së vonë, duke vazhduar edhe për kohën e re. Pra, mund të thuhet se zeja e argjendarisë, që quhej edhe zeja e kujunxhinjve, jetoi në antikitet, vazhdoi të jetojë edhe në shekullin e mesëm dhe arrin deri në ditët e sotme, por duke shtuar edhe emërtimin filigran.

Të mos e harrojmë storien që për hapësirën e Kosovës dhe të qyteteve të saj zhvillimin e argjendarisë shumë herë e shpjegon në lidhje të ngushtë me zhvillimin e xehetarisë, të nxjerrjes së xeheve nga nëntoka dhe të vendeve ku gjendeshin xeheroret, sikurse janë Trepça në qytetin e Mitrovicës, ose Novobërda e shek. XIV-XV me 40.000 banorët e saj, që dikur ishte qytet i madh, i krahasueshëm me qytete evropiane.

Vazhdojmë storien na ishte njëherë..., pikërisht kështu, një zeje e zhvilluar e argjendarisë, prodhimet e të cilës: falë cilësive dhe kualiteteve të veta të larta, u ekspozuan dhe u shiten jo vetëm në Kosovë, kudo në trojet shqiptare dhe në Ballkan, por në shek. XIX arritën edhe në tregjet e: Egjiptit e të Sudanit, të Etiopisë, Azisë së Vogël, të Persisë dhe Indisë, të Stambollit e të Parisit. Përveç stolive për meshkuj e për femra, edhe zbulurimi ose veshja e armëve të zjarrit me fije të holla të argjendit, arrijnë sukses dhe nam e famë brenda vendit të vet dhe jashtë vendit, sa që për stilin e vet karakteristik të punës dhe të modelimit, arrijnë të njihen dhe të



identifikohen si filigran i tejdukshëm shqiptar, (kili kafazli arnaut filigran), ose filigran kafesli (i thurur-qëndisur me fije argjendi e teknika të ndryshme).

### **Vazhdimësia e filigranit**

Storia na mësoi se në hapësirën e Republikës së Kosovës, por edhe në hapësira të tjera shqiptare kudo qoftë, argjendaria dhe filigrani i punuar dhe i modeluar në forma të ndryshme artefaktuale paraqitet në antikitet, vazhdon në mesjetën e hershme e të vonë dhe duhet të shtojmë, se kulminacionin e arrinë në shekujt XVII-XVIII dhe XIX. Për fat të keq sot filigrani gjallëron me modesti, por në anën tjetër, për fat të mirë ka tendenca që kjo zeje të përtërihet. Kjo storie e jona e pasqyron këtë dëshirë e gjendje të filigranit, posaçërisht këtu në Prizren, ku ja se edhe ju do të shijoni një punëtori të këndshme dhe mësim tërheqës të kësaj zejeje.

### **Çka na tregon historia për llojet e artefakteve filigraniste?**

Stolitë për femra: mbulesat e kokës si dekor që janë: kapuçi me pare, dasfesi, tërthoret dhe balloret, vathët, gjerdanët e fytit dhe të gjoksit, medaljonet, zinxhirët dhe varëset e ndryshme. Stolitë për burra: kopsat për xhamadanët, qostekët, unazat, çibukë të veshur me filigran, dhe për të kaluarën gjithsesi armët e zjarrit – të stolisura me pafta argjendi, ose të lara me ar e me punesë filigranike. Ka pasur edhe enë të ndryshme, objekte-artefakte kultike për manastire, tematizime si fjala vjen Anija, Lidhja e Prizrenit, Hyjneshja në fron e të tjera. Kishte dhe ende ka artefakte, të cilat punohen si përfaqësim e simbol i një vendi, i një qyteti ose si objekte të destinuara ekskluzivisht për dhurata të veçanta. Secili objekt-artefakt ka gjuhën dhe stilin e veçantë, me të cilin komunikon dhe në të njëjtën kohë ligjëron realitetin dhe kohën vetë.




## Si jeton filigrani sot?

Storia vazhdon edhe për kohën e shekullit XXI, por tani ka fare pak dyqane filigraniste me fare pak mjeshtër filigranistë. Në muzeume e në institucione shoqërore ruhen koleksione dhe ekzemplar të veçantë filigranik, si ato të mjeshtrit nga Peja, Viktor Gashi, ose janë të ekspozuara, si fjala vjen medaljonet e famshme të Simon Shirokës në Bibliotekën Kombëtare e Universitare të Prishtinës. E bukura e kohës tonë është se

Fig. 6. Prof. Dr. Drita Halimi – Statovci me filigranë dhe studentët





fija e argjendit nuk ndalon, por vazhdon të thur artefakte të bukura mbresëlënëse filigranike.

Storia thekson se na ishte njëherë..., filigrani disi zeje e “rezervuar” vetëm për meshkuj. Mirëpo, në Prizren deri para dhjetë vitesh punoi mjeshtrë Sadije Turtulla, ndërsa në Shoqatën e sotme “Filigran” punon mjeshtrë Fatime Baruti dhe në Prishtinë punon arkitektja-mjeshtrë Krenare Rakovica. Megjithatë hulumtimet e mija tregojnë se ka pasur edhe mjeshtrë të tjera, por që kanë punuar kryesisht në shtëpi, duke mbetur kështu të panjohura.

Në Prizren ose në Prishtinë, në Pejë ose në Gjakovë, por edhe në qytete të tjera puna filigranike mban në vete një leksik, ose një terminologji tejet të pasur dhe interesante të emërimit: të materialit, të teknikës dhe të procesit të punës, të veglave, të motiveve dhe leksikun e prodhimeve – artefakteve apo produkteve të gatshme finale.

Së fundi, historia na sugjeron që tani së bashku të shikojmë artefaktet që kam sjellë këtu, ta mbajmë në dorë një artefakt, ta ndiejmë një filigran të zbardhur, të nxirë, ose të kombinuar e të pasuruar edhe me gurë ngjyrash të gjallërishtme dhe ta shijojmë ndjenjën që jep filigrani i bukur. Së bashku këto krijojnë: tablo estetike, tablo stilesh të ndryshme pune, tablo ngazëllyese, histori epokash, tematizime të caktuara e të ngjashme.

Dhe si përfundim, historia jonë na orienton të zbatojmë metodën e bashkëbisedimit. Unë jam e lumtur se një zeje sa e vjetër aq edhe e re, sot na bëri bashkë juve të rinj, që kërkon dije të reja, dhe mua një pedagoge tani në pension, pikërisht këtu në Prizren.





Fig. 7. Filigrani





## Betim Elezi


Zyrtar i lartë për trashëgimi shpirtërore  
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore

### PIKTURIMI I FYTYRËS NË KOSOVË

Pikturimi i fytyrës, i njohur ndryshe edhe si ngjyrosje ose vizatimi i fytyrës, si dukuri e gjejmë që nga kohërat e lashta, të ruajtur në forma të ndryshme tek shumë popuj të vjetër nëpër botë.

Të shumtë janë autorët nga shkenca e Antropologjisë dhe fushave tjera humane që e marrin për trajtim këtë dukuri apo traditë shumë domethënëse. Sipas teoricienëve, vizatimin e fytyrës e gjejmë te popujt e ndryshëm që nga kohërat e lashta, keltët në Europë, grupet shoqërore në Indi, Kinë, Japoni, Australi, Zelandë e Re dhe te popujt e lashtë të Amerikës Veriore e Jugore. Për shumë nga këta popuj, ngjyrosja e fytyrës bëhej për efekt të mbrojtës nga magjia. Po ashtu, ngjyrimin e fytyrës e hasim edhe për qëllime të tjera, si formë maskimi në gjuetinë e kafshëve të egra që ishte burim jetese i njerëzve në lashtësi, sidomos në kontinentin e Afrikës.

Pikturimin, ngjyrimin apo vizatimin e fytyrës e hasim edhe në kulturën shqiptare. Kur njeriu, kalon nga një fazë e jetës në tjetrën në studimin antropologjik njihet si “rit kalimi”. Në rastin tonë ndodhë kur vajza nga statusi civil e fejuar kalon në statusin tjetër, e martuar. Dhe pikërisht për këtë gjë në ditën e nusërisë familja e ngushtë dhe ajo më e gjerë i kushtonte rëndësi të madhe rregullimit të fytyrës së nuses dhe dukjes së jashtme në përgjithësi.



Përderisa në popull ky proces njihet edhe si “mbrojtje nga syri i keq”, etnologia Prof. Dr. Drita Halimi-Statovci në botimin e saj “Pikturimi i fytyrës në Kosovë ndërmjet Traditës dhe Modernitetit”, e trajton këtë traditë si një lloj arti apo transformim të fytyrës së njeriut. Autorja tregon se në qytetet në të cilat ajo kishte realizuar hulumtimin (Prishtinë, Vushtrri, Mitrovicë, Pejë dhe në qytezën e Janjevës) praktikohet pikturimi i fytyrës e që në popull njihet si “teleisje”. Respektivisht ky art është aplikuar te gjinia femërore, pra zbatohet vetëm për vajzën që bëhet nuse për herë të parë në jetën e vet dhe gjithashtu edhe për gratë e martuara që ndryshe në popull njihen si nuse e re.

Tradita e pikturimit të fytyrës në vete ngërthen edhe përdorimin e ngjyrave të ndryshme sipas simbolikave me kuptim domethënës. Procesi i pikturimit fillon me lyerjen e fytyrës së nuses me ngjyrë të bardhë e cila shërben edhe si ngjyrë bazë dhe simbolizon paqen, mbarësinë, plleshmërinë, gjallërinë dhe gëzimin. Mjetet të cilat i përdor piktoria për vizatimin e fytyrës së nuses janë të thjeshta, këto mjete ishin ndihmëse dhe çdo piktore i rregullonte sipas dëshirës së vet. Në rastet kur e hasim aplikimin e ngjyrës së kuqe në formë pikash, e cila përveç se shërbente si dekor, ajo në traditën shqiptare simbolizonte edhe mbrojtjen nga demonët, (raste të kësaj simbolike e hasim kur qerrja e nuses mbulohej me një qilim ngjyrë të kuqe). Ndërsa, aplikimi i ngjyrës së kaltër bëhej për mbrojtje nga syri i keq.



Fig. 8. Aplikimi i shabllonëve në formë të rrathëve



Fig. 9. Pikturimi i fytyrës





Pas aplikimit të ngjyimit të fytyrës, bëhet dekorimi i fytyrës së nuses. E rëndësishë së veçantë dhe që e bën më autentike është simbolika e autentike është simbolika e cila aplikohet në vizatimin e fytyrës. Në të shumtën e rasteve, në vizatimin e fytyrës e hasim formën e rrethit në të dy anët e faqeve apo të mjekrës, që simbolizon diellin, por ka edhe mendime tjera, varësisht prej qyteteve apo krahinave etnografike, ku mendohet se rrrathët e aplikuar në fytyrë simbolizojnë proceset e jetës në vazhdimësi.

Në lashtësi, materialet të cilat përdorehin për ngjyrosje, ishin të nxjerra nga lëndë natyrore, me origjinë bimore si vajra bimore si dhe ato me origjinë minerale dhe shtazore.

Në ditët e sotme praktikimi i pikturimit të fytyrës thuhet se është në zhdukje dhe haset në raste shumë të rralla, por është shumë e rëndësishme ruajtja e kësaj tradite shumë të lashtë, e cila nuk e ndan as kulturën shqiptare nga popujt e lashtë dhe civilizimet e hershme.

Më 17 tetor 2003, në Paris, UNESCO ka miratuar Konventën për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jo

Fig. 10. Faza të ndryshme dekorative

materiale, përmes së cilës synohet të ruhet diversiteti kulturor si garanci e zhvillimit afatgjatë, për vullnetin e përbotshëm dhe për shqetësimin e përbashkët për të ruajtur trashëgiminë kulturore jo materiale të njerëzimit, gjithashtu duke pranuar se bashkësitë, në veçanti bashkësitë rrënjese, grupet dhe, sipas rastit, individët luajnë një rol të rëndësishëm në prodhimin, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe rikrijimin e trashëgimisë kulturore jomtareriale, duke ndihmuar kështu për pasurimin e diversitetit kulturor dhe të krijimtarisë njerëzore.

Prandaj, komuniteti që e praktikon duhet të përkrahët edhe nga institucionet e trashëgimisë kulturore dhe entuziastët në vendin tonë për të gjetur mënyra efektive të përcjelljes dhe ruajtjes së praktikave të trashëgimisë kulturore shpirtërore (jo materiale) tek gjeneratat e ardhshme. Kjo pasuri unike me vlera universale e tejkalon rëndësinë dhe kontekstin vendor dhe rajonal.



Fig. 11. Fytyra me vizatimet përfunditare dhe aplikimi i fudit dekorativ







Fig. 12. Veshja tradicionale



Fig. 13. Pamja përfundimtare





## **“ZEJA TRADICIONALE E FILIGRANIT” NË QYTETIN E PRIZRENIT**

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore në partneritet me European Heritage Volunteers nga datat 27 shtator – 9 tetor 2022, organizoi trajnimin “Zeja tradicionale e filigranit” në qytetin e Prizrenit.

Qëllimi i këtij projekti ishte trajnimi i vullnetarëve nga vende të ndryshme të botës në fushën e trashëgimisë kulturore. Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin shtatë studentë dhe profesionistë nga këto shtete: Franca, Gjermania, Kosova, India, Egjipti dhe Spanja. Përveç punës praktike u realizuan edhe ligjërata të hapura e prezantime rreth temave, eksperiencave të ndryshme nga trashëgimia shpirtërore.

Filigrani si teknikë e avancuar e aplikimit artistik të zejes së argjendarisë arriti kulminacionin në shek. XIX, kryesisht në qendrat urbane të mirënjohura për prodhimtari dhe përpunim metalesh të çmuara, siç ishte në atë kohë qyteti i Prizrenit. Vazhdimësi e kësaj tradite të përcjellë ndër breza nga mjeshtrit filigranistë vendas që sot rrezikohet të shuhet, përkundër arritshmërisë së lartë artistike të tyre dhe laryshisë së stolive.

Kursi i trajnimit është fokusuar në dokumentimin e punës së zejtarëve vendas të filigranit si dhe përvetësimin e teknikave të filigranit për punime të ndryshme pasi që është udhëhequr nga specialistë me përvojë. Përgjatë dy javëve pjesëmarrësit patën mundësi të marrin njohuri teorike dhe praktike në lidhje me teknikat tradicionale të filigranit – mjeshtri e kahmotshme dhe pjesë e trashëgimisë jomateriale shpirtërore e vendit tonë. Në javën e parë në disa qytete të Kosovës, pjesëmarrësit zhvilluan vizita në familje të filigranistëve të vjetër të cilët për dekada ende

e ushtrojnë zanatin, për të dokumentuar historikun e ushtrimit të kësaj zeje të vjetër me rëndësi për shoqërinë tonë. Po ashtu, ata patën mundësinë të eksplorojnë një sërë monumente të trashëgimisë kulturore si Çarshinë e Gjakovës dhe Xhaminë e Hadumit, Çarshinë e gjatë të Pejës, Parkun Arkeologjik të Ulpianës, Muzeun Etnologjik dhe Muzeun Kombëtar në qytetin e Prishtinës etj.

Këto asete dhe peizazhi kulturor i larmishëm ndihmoi pjesëmarrësit të kuptonin më mirë trashëgiminë kulturore të pasur dhe historinë e Kosovës.

Java e dytë iu përkushtua punës praktike në njërën nga punëtoritë e filigranit në qytetin e Prizrenit. E udhëhequr nga mjeshtër vendas me përvojë shumëvjeçare kjo pjesë e kursit u fokusua në marrjen e aftësive bazike në lidhje me punimin e filigranit dhe zbatimin e tyre në praktikë. Në fund të kursit të trajnimit pjesëmarrësit patën mundësi të bënin vetë punime artistike me anë të teknikës së filigranit.

Në ceremoninë përmbyllëse pjesëmarrësit prezantuan punën e bërë gjatë këtij trajnimit si dhe në fund u ndanë certifikatat e pjesëmarrjes.

## Enis Bytyqi

Student i Antropologjisë Kulturore, Fakulteti Filozofik  
Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

### FILIGRANI – ZEJE E NGRIRË NË KOHË

Përgjatë 27 shtatorit dhe 9 tetorit të vitit 2022, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe European Heritage Volunteers mbajtën një kurs për zejën tradicionale të filigranit në Prizren. Shtatë pjesëmarrës nga gjashtë vende të botës qëndruan për trembëdhjetë ditë në qytetin e Prizrenit, fillimisht për të njohur historinë dhe teknikën e zejës së filigranit, ndërkaq më vonë për t'i vënë në praktikë njohuritë e fituara.

Zeja e filigranit ka një histori të gjatë në Kosovë, ajo shtrihet me mijëra vite deri në antikitet. Kjo dëshmohet edhe me inventarin arkeologjik të gjetur në tumat ilire, i përbërë nga bizhuteritë argjendi. Megjithatë, të dhëna të dokumentuara mbi këtë zeje së pari na vijnë nga periudha osmane. Ne vitin 1591, në një *Defter* osman ishin regjistruar pesë punishte të argjendit në Kosovë, katë nga to në pronësi të të krishterëve dhe një në pronësinë e një muslimani. Zanati si i tillë vazhdoi të lulëzonte gjatë periudhës osmane, duke arritur kulmin në shekullin e XIX-të. Në vitin 1866, një konsull francez në Shkodër shkruan për Prizrenin, duke përmendur 47 dyqane argjendarie të specializuara në filigran, 15 të specializuara në dekorimin e armëve dhe pesë për zbukurimin e gërshtëre dhe thikave, gjithashtu me argjend. Zanati i filigranit ishte aq i njohur në Prizren, sa që Prizreni kishte edhe një lagje të destinuar për zanatlinjë të quajtur “Mahalla e Kujunxhive”, e cila përfshinte më shumë se 100 punishte – jo vetëm argjendari, por edhe filigran, punime bakri, punime me ar etj. Kjo zonë ishte qendër për këtë zeje specifike deri ne vitin 1945.

Mënyra kryesore e mësimit të kësaj zeje është ende mënyra tradicionale – ajo e organizimit dhe mbajtja e zejes brenda familjes. Rrjedhimisht kjo ka ndikuar në mungesën e interesimit të brezit të ri, të cilit nuk i pëlqejnë orët e gjata të punës që nevojiten për të zotëruar zanatin dhe as paga e ulët që vjen pas shitjes së produktit. Zvogëlimi i mëtejshëm i numrit të familjeve filigranpunuese në Kosovë është mungesa e qasjes në tregun kroat, i cili dikur ishte një nga rrugët kryesore mbështetëse të

Fig. 14. Në vendpunishten e filigranit në Prizren



eksportit të zejes. Aktualisht, në Kosovë ata që duan ta mësojnë filigranin, mund ta bëjnë në shkollën “Filigrani” në Prizren.

Gjatë javës së parë ne si grup patëm mundësinë të vizitojmë disa familje filigranpunuese në qytetin e Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit, ndër to familja Çivlaku në Pejë, ajo Nikollëbibaj e Pasuli në Prizren. Ishin këto vizita këto të cilat na ofruan një pasqyrë reale të zejes duke u bazuar në historitë personale, praktikat dhe problemet me të cilat ballafaqohen sot këto familje.

Fig. 15. Pjesëmarrësit mësojnë punimin me filigran



Përveç intervistimit që e kryem gjatë pjesës së parë të kursit trajnues, në javën e dytë patëm mundësinë të mësojmë bazat e zejës së filigranit në shkollën e filigranit në Prizren të quajtur “Filigrani”. Kjo zeje kërkon muaj për t’u mësuar dhe vite për t’u zotëruar, por brenda një harku kohor shumë të shkurtër ne arritëm të mësojmë të gjitha bazat e filigranit sipas traditës së filigranit në Kosovë. Ishte një nder për mua të mësoj një praktikë kaq të vjetër, ashtu siç ishte nder të takoja edhe familje të shumta të argjendarëve dhe të mësoja më shumë nga ata. Këto vizita shpresoj që të kenë shërbyer edhe si një mundësi për t’u treguar atyre se ekziston vërtetë një interes ndërkombëtar për zanatin. Institucionet dhe organizatat qeveritare, ato joqeveritare si dhe ato ndërkombëtare mund të bëjnë shumë për të ndihmuar këtë veprimtari të mbijetojë. Qytetarët gjithashtu kanë rol të madh në jetëgjatësinë e zejës së filigranit.

Gjatë këtij kursi kam kuptuar mbi rëndësinë e filigranit që ka për identitetin kulturor të qytetit të Prizrenit. Rëndësi kjo e mësuar mirë nga të gjitha aspektet që ngërthente ky kurs trajnues duke filluar nga njohuritë teorike e deri tek mundësia për të praktikuar punën me filigran. Mbi të gjitha ky kurs trajnues për mua ka shërbyer duke fituar njohuri, përvoja të ndryshme dhe shoqëri të reja. Si grup kemi arritur në një përfundim se zeja e filigranit nuk e ka vëmendjen e merituar andaj dhe ky projekt u përpoq me modesti t’i sjellë më shumë vëmendje dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në mbijetesën e zanatit.

Fig. 16. Pjesë të elementeve për përdorimin e dekorues të filigranit



## **Aranit Krasniqi**

Student Master në Arkivistikë. Departamenti i Historisë, Fakulteti Filozofik  
Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

### **PËRBALLË NJË TRADITE MIJËVJEÇARE NUSËRIE**

Të hënën me 3 Tetor në ambientet e Kino Lumbardhit, grupi punues i përbërë nga pjesëmarrësit e programit trajnues “Zeja Tradicionale e Filigranit 2022” në qytetin e Prizrenit, si dhe ekipi nga Këshilli i Kosovës për Trashigimi Kulturore dhe të ftuar të tjerë patën mundësi ta shohin procedurën tradicionale të pikturimit të fytyrës së nuses në ditën e dasmës. Kjo ditë që e ngjeshur me shumë prezantime të tjera që mbërthenin fusha të ndryshme kulturore, si nga Kosova dhe nga vende të ndryshme të botës nga ku vinin pjesëmarrësit e trajnimit. Por kjo performancë tradicionale e ekzekutuar nga zonja Aziza Shefetaqi, një e moshuar nga komuniteti tërbesh në komunën e Prizrenit, padyshim që tërhoqi më së shumti vëmendje, duke u bërë gjithashtu edhe atraksioni kryesor në mediat sociale të Këshillit të Kosovës për Trashigimi Kulturore dhe European Heritage Volunteers. Përgjatë kësaj praktike të gjithë patën mundësi të mësonin për këtë traditë të lashtë mijëvjeçare, por edhe të shihnin se si ajo praktikohet edhe sot, ndonëse tani vetëm nga një komunitet i vogël në cepin jugor të Kosovës.

Tradita e pikturimit të fytyrës së nuseve shkon mbrapa me mijëra vite. Atë mund ta vërejmë deri tek kulturat e periudhës së bronzit në Mikenë, dëshmitë arkeologjike siç është koka e një statuje femërore që shfaq një grua, si duket një nuse, me fytyrë të ngjyrosur e pikturuar pothuajse njëjtë sikurse nuset që pikturohen në fshatrat e Gorës. Padyshim kjo traditë përveç se është e lashtë, ajo ishte poashtu mjaft e përhapur në

Fig. 17. Veshja tradicionale





Pakistani dhe India Veriore, deri tek pellgu i Mesdheut në vende si Tunizi, Bullgari, Maqedoni Veriore dhe natyrisht në Kosovë.

Fotografi të viteve 1960 tregojnë se si kjo praktikë ishte prezente edhe në Prishtinë, por me kalimin e kohës dhe me arritjen e modernitetit, kjo traditë si dhe shumë të tjera, po shkon drejt zhdukjes, duke lënë tani vetëm një apo dy të moshuara nga komunitetet goran dhe tërbesh, që ende vazhdojnë të praktikojnë këtë traditë.

Përderisa zonja Shefitagiq po kryente pikturimin e nuses, rol që në këtë rast u vendos ta lunate njëra nga pjesëmarrëset, ne patëm mundësi që të mbledhim mjaft të dhëna sa i përket kësaj praktike. U mësua se kjo praktikë performohet për ta mbrojtur nusen si dhe çiftin që martohet nga fatkeqësitë dhe nga syri i keq, ashtu si dhe për t'iu sjellë lumturi në jetën martesore. Ngjyrat të cilat më heret të gjitha ishin prodhuar nga familja e nuses, tani shumë prej tyre blihen në dyqane dhe përdoren për këtë qëllim. Ngjyrat të gjitha kanë simbolikat e tyre: rrathët me ngjyrë të kuqe simbolizojnë plleshmërinë, tre rrathët e verdhë simbolizojnë të tri fazat e jetës (vajzërinë, pastaj martesën si grua e nënë dhe në fund pleqërinë), ndërsa pikat e kuqe dhe të kaltra sigurojnë se nusja do të ketë një familje të lumtur dhe të shëndetshme. Duke parë këtë shpjegim edhe mund të kuptohet funksioni i kësaj praktike të lashtë në shoqëri të ndryshme, në periudha të hershme, kur bestytnitë luanin rol kyç në jetën e përditshme të njeriut. Atëbotë ishte më se i nevojshëm praktikimi i ritualeve të tilla, për të tentuar të garantojnë jetën e lumtur dhe të plleshme, që për ato kohë ishte mjaft e vështirë për t'u siguruar.

Gjatë tërë kohës “nusja” ishte e shtrirë dhe i mbante sytë mbyllur, duke mos mundur as të lëvizte muskujt e fytyrës, pasi që një gjë e tillë do të dëmtonte ngjyrat nga rrudhja. Së pari, fytyra e saj u lye me të bardhë dhe pastaj filluan vendosjet e rrathëve të mëdhenj e të verdhë dhe më pas rrathët tjera dhe pikat e kuqe dhe të kaltra.

Fig. 18. Vizatimi i figurave abstrakte me elemente tradicionale-gjeometrike



Megjithatë kjo procedurë të cilën ne arritëm ta shohim vetë, nuk ishte tërësisht e njëjtë me atë që performohet në ditën e dasmës, natyrisht kjo ishte vetëm një shfaqje dhe jo një dasmë e vërtetë, mirëpo për të kuptuar më mirë ritualin duhet përmendur edhe dallimet. Gjatë tërë kohës, përderisa fytyra e nuses pikturohet, ajo mban sytë mbyllur, ndërsa përreth saj gratë e shtëpisë këndojnë këngë për martesën e saj. Pasi krushqit e marrin dhe e dërgojnë në shtëpinë e burrit dhe pas ritualeve e ahengjeve të tjera gjatë ditës, para futjes në dhomën e gjumit, është burri ai i cili duhet t'ia fshijë fytyrën nuses. Natyrisht, siç u theksua më lartë, ne pamë vetëm një demonstrim të procesit të pikturimit dhe jo një dasmë të vërtetë, por padyshim që edhe kjo shfaqje ngjalli shumë kureshtje dhe solli mjaft informacione për trashëgiminë e gjallë kulturore që ende nuk është zhdukur tërësisht në Kosovë.

Mundësia për të parë këtë praktikë duke u performuar para syve tonë, ishte një nder i madh si për audiencën vendore ashtu edhe për atë të pjesëmarrësve ndërkombëtarë dhe u arrit që kjo traditë që po shkon drejt zhdukjes, për pak kohë të merrte vëmendje si nga të pranishmit, poashtu edhe nga audienca e mediat sociale. Një hap i vogël, por gjithsesi i rëndësishëm dhe qëllim mirë për ta ruajtur edhe një traditë tjetër përveç zejës së filigranit, rreth së cilës ishte përqendruar i tërë trajnimi.

Duke shpresuar se në të ardhmen do mund të shpëtohet nga zhdukja dhe që ky ritual të ruhet dhe njihet ashtu siç e meriton.

Fig. 19. Praktikë dhe biseda





Aktivitet  
për t'u shënuar

Fig. 20. Pjesëmarrësit shijojnë vështrimin gjatë procesit tradicional të pikturimit të fytyrës







Fig. 21. Pikturimi i fytyrës  
përbëhet nga disa faza

Fig. 22. Piktorja që sheh “veprën” nuse





Fig. 23. Pjesëmarrësit në fund të aktivitetit



Fig. 24. Elemente zbukuruese të veshjes



Fig. 25. Studentja - nuse



Fig. 26. Pjesëmarrësi gjatë punës me filigran





Fig. 27. Faza të ndryshme punimesh



Fig. 28. Forma të ndryshme dekorimesh



Fig. 29. Forma të ndryshme dekorimesh



Lecture: The Filigree in Republic of Kosovo

Fig. 30. Prof. Dr. Drita Halimi – Statovci në bisedë me pjesëmarrësit

- Now, instead of conclusion, I'm inviting to have a conversations together. I am happy that a craft as old and as new, today brought together you young people, who are looking for new knowledge-skills and me, a now retired professor, right here in Prizren.
- By the end of the 19th century, this city had 124 kinds of craft. 27 crafts of metalprocessing, namely goldsmiths, silversmiths and hanhermezhin, decorating firearms. We are together in a perfect city to develop a conversation about the discourse of an artistic craft, we are in the leading city of filigree, which is part of the identity of Prizren, but also of Kosovo. Therefore, I expect you to express your feelings and interest, while I will help you as much as i can.



Fig. 31. Në ligjëratë





Fig. 32. Në ligjëratë



Fig. 33. Vizitë në dyqan filigrani



Fig. 34. Filigranë për përdorim të ndryshëm





Fig. 35. Fotografii e përbashkët në dyqan filigrani



Fig. 36. Vizitë në argjendari



Fig. 38. Vizitë në Muzeun Etnografik “Emin Gjiku”, Prishtinë





Fig. 38. Ekspozitë interaktive në Muzeun Etnografik “Emin Gjiku”





Fig. 39. Gjatë vizitës në Muzeun Etnografik “Emin Gjiku”



Fig. 40. Gjatë vizitës në Xhaminë e Hadumit, Gjakovë



Fig. 41. Në Muzeun Kombëtar të Kosovës  
dhe në Muzeun Arkeologjik në Prizren



Fig. 42. Gjatë aktivitetit përmbyllës



Fig. 43. Fotografi grupore e pjesëmarrësve me certifikata





